



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Gjatë muajit Shkurt kemi hasur në 23 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjë regjistrimin e tyre pranë qendrës së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan gjithashtu kemi pasur 27 biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtorisë së Inspektoratit tek Inspektoret e Tregut.

Në bazë të kërkesave të bizneseve kemi bërë pranime teknike me procesverbal për plotësimin e kushteve tekniko minimale për të ushtruar veprimtarin e tyre, gjatë kontrolleve kemi hasur në mall me afat të skaduar në vlerë prej 33.00€, po ashtu së bashku me inspektorin sanitar dhe inspektoret e agjensionit të ushqimit dhe veterinarisë kemi asgjësuar 9 krerë lopë, në pronën e tij të cilët ishin të diagnostikuar me Brucelozë.

Gjatë këtij muaji janë bërë inspektime të subjekteve të ndryshme afariste ushqimore si depo, restoranteve, marketet e ndryshme ushqimore, furrat e bukës, të gjitha janë inspektuar në aspektin higjieno sanitar, për të gjitha vërejtjet është dhënë urdhër me procesverbal për eliminimin e mangësive.

Po ashtu në këtë muaj është bërë inspektimi i Qendrës për persona me nevoja të veçanta në Lipjan si dhe fabrika e sheqerit

Nga Kryeinspektori Sanitarë i Kosovës është dhënë një urdhëresë për inspektim të subjekteve afariste ushqimore për të verifikuar se a gjendet në shitje produkte të prodhuesit Bawella nga Turqia me distributor për Kosovë Elnart SHPK.-Pejë, të cilat produkte mund të jenë me afat të skaduar, pas urdhëses së marrë në menjëherë kemi filluar me aksionin e inspektimit të marketeve dhe depove ushqimore të në qytet dhe rrethinë për të bërë kontroll për produkte ushqimore të prodhuesit të lartëcekur dhe gjatë inspektimit produkte të tilla nuk janë gjetur.

Është inspektuar në bazë të kërkesave të palëve dhe planit tonë. Inspektimi është bërë në disa fshatra dhe në qytet, me ç'rast janë dhënë urdhëresat dhe vërejtje me shkrim dhe me gojë për sanimin e parregullsive, kërkesat kishin të bëjnë me plehrat e kafshëve dhe mbeturinat.

Janë inspektuar vendgrumbullimet e mbeturinave në qytet dhe rrethinë.

Gjatë këtij muaji është formuar komisioni rreth Lejes Mjedisore Komunale ku janë shqyrtuar kërkesat dhe janë pajisur me LMK dy biznese.

Në kodrën e Kërqevës është bërë ndalimi i bartjes dhe shitjes së materialit të marrë nga rrafshimi i kodrave nga kompania kontraktuese e cila ka qenë përgjegjëse vetëm për rrafshim të asaj zone ekonomike.

Kemi marrë pjesë në komision për hapësirat publike në bashkëpunim me DEMOS.

Në muajin Shkurt është bërë inspektimi i të gjithë transportuesve të udhëtareve si auto-taksit dhe kompanitë e autobusëve, janë kontrolluar edhe parkingjet e autotaksive në rrugët e qytetit se mos po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale po ashtu edhe në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë në bashkëpunim me policinë kufitare, është inspektuar edhe rruga Medvec-Magure ku miniera e Feronikelit është duke bërë rregullimin e rrugës për devijimin e një pjese të rrugës nga Medveci në drejtim të Magures.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar marketet ushqimore për produkte me prejardhje bimore. Në disa markete ushqimore janë larguar nga shitja pemë dhe perime si rezultat i dëmtimeve fizike dhe nga temperaturat e ulëta.

Gjithashtu janë inspektuar të gjithë shitësit dhe tregtuesit e plehrave artificiale që operojnë në Komunën tonë, po ashtu janë inspektuar tokat bujqësore të cilat kanë filluar të mbushen me materiale të ndryshme si dhe atyre që po u ndërrohet destinimi
 Gjithashtu janë inspektuar edhe toka me kultura Bujqësore që janë dëmtuar si rezultat i reshjeve atmosferike.
 Të dhënat statistikore më të hollësishme janë të paraqitura në tabelën e më poshtme:

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Të hyra nga pranimet teknike	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra,plehradhe pesticide dhe toka bujqësore	Biznese të pargjijstruara dhe pa pranime teknike	Mallë me afat të skaduar
Biznesit	513	50	8			71	12	100	81			10	92	139	125€		12		50	33€
Ambientit	234	19							92					116			7			
Bujqësisë	219	18				46			71					53				31		
Ndërtimtarisë																				
Trafikut	405	29		1		85	3	36		104	8		67			72				
Sanitar	212	20			59	45		72	1				15							33€
Gjithsejtë	1583	136	8	1	59	247	2	11	352	1	104	18	92	390	125€		81	31	50	33€